



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 4292 Prishtinë, Dt. 14.10.2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Kimi Analitike & Kimi Mjedisore
Titulli	Vlerësimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në pellgun e Drinit të Bardhë
Kandidatja	Valmire Krasniqi
Mentori	Prof. Dr. Tahir Arbneshi
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 28. 03. 2025
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr. 1083

**Vlerësimi i dorëshkrimit**

Dorëshkrimi i temës së masterit me titull "Vlerësimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në pellgun e Drinit të Bardhë" është shkruar në gjuhën shqipe dhe struktura e tij i përgjigjet standardeve akademike të një pune shkencore të nivelit master. Struktura e tij përfshin pjesën teorike, pjesën eksperimentale, rezultatet dhe diskutimin, përfundimet, rezymenë në gjuhën shqipe dhe angleze, dhe literaturën. Punimi trajton një tematikë me rëndësi të veçantë shkencore dhe mjedisore për vlerësimin e cilësisë së ujërave në pellgun e Drinit të Bardhë.

Në kapitullin e parë, është paraqitur një pasqyrë e qartë dhe e plotë e problematikës së ujërave dhe rëndësisë së tyre, duke u përqendruar në ndotjen me metale të rënda dhe ndotës të qëndrueshëm organikë. Janë trajtuar në detaje burimet e ndotjes, përfshirë ato antropogjenë si ndotja industriale, bujqësore dhe urbane, si dhe burimet natyrore, duke përfshirë ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore dhe faktorët gjeologjikë. Të dhënat janë mbështetur në literaturë bashkëkohore, duke siguruar një bazë të mirë shkencore dhe mjedisore. Gjithashtu trajtohen efektet toksike të metaleve të rënda dhe ndikimi i ndotësve organikë, duke përfshirë pesticidet klor-organike (OCP), bifenilet e polikloruara (PCB) dhe hidrokarburet aromatike policiklike (PAH). Kandidatja ka shfaqur qasje të thellë studimore dhe ka përdorur burime të reja dhe të rëndësishme shkencore, duke dhënë lexuesit kuptim të qartë të sfidave mjedisore që lidhen me ujërat e pellgut të Drinit të Bardhë.

Kapitulli i dytë fokusohet në teknikat instrumentale të përdorura në këtë studim. Kandidatja ka përshkruar në detaje Plazmën e çiftuar me induksion me spektrometrinë e masës (ICP-MS) dhe Kromatografinë e gaztë me detektor të spektrometrisë së masës (GC/MS), duke treguar zotërim të teknikave instrumentale të avancuara dhe aplikimin e tyre në arritjen e objektivave të studimit. Përshkrimi i procedurave është i

plotë dhe mbështet qasjen shkencore të punimit.

Kapitulli i tretë paraqet materialet dhe metodat eksperimentale, ku kandidatja ka dhënë informacion të qartë mbi marrjen dhe ruajtjen e mostrave, pajisjet dhe substancat e përdorura, si dhe procedurat e detajuara eksperimentale. Të gjitha këto janë të mbështetura në literaturë të fundit, duke demonstruar rigorozitet shkencor dhe përputhje me standardet laboratorike.

Në kapitullin 4 (Rezultatet dhe diskutimi), rezultatet janë paraqitur në mënyrë kronologjike dhe të organizuar, duke filluar me parametrat fiziko-kimikë të ujërave dhe duke vazhduar me përqendrimet e metaleve të rënda dhe ndotësve organikë. Kandidatja kombinon me mjeshtëri prezantimin dhe diskutimin e rezultateve, duke i interpretuar ato në mënyrë të qartë dhe logjike për lexuesin. Rezultatet eksperimentale krahasohen me të dhënat nga literatura bashkëkohore, duke ofruar një diskutim gjithëpërfshirës që nxit kuptimin dhe aplikimin praktik të të dhënave.

Përfundimet e dorëshkrimit janë të qarta, të argumentuara dhe të mbështetura në rezultatet eksperimentale. Ato reflektojnë plotësimin e objektivave të studimit dhe konfirmojnë hipotezën e vendosur në fillim. Kandidatja ka arritur të demonstrojë kompetencë në përdorimin e metodave instrumentale të analizës kimike, si dhe aftësi për interpretimin shkencor të të dhënave. Përfundimet kanë vlerë teorike dhe praktike, duke ofruar një kontribut të rëndësishëm në monitorimin e cilësisë së ujërave në pellgun e Drinit të Bardhë.




Dorëshkrimi mbështetet në literaturë të pasur dhe të përditësuar, duke treguar aftësi të mirë të kandidatës në mbledhjen dhe analizimin e informacioneve shkencore relevante.

Në përmbledhje, dorëshkrimi i kandidatës Valmire Krasniqi reflekton angazhim të lartë akademik, rigorozitet shkencor dhe qasje të strukturuar në hulumtimin e ndotjes së ujërave. Tema ka rëndësi të veçantë mjedisore dhe kontributi i saj aplikativ në monitorimin e cilësisë së ujërave e bënë punimin të vlefshëm si për komunitetin shkencor, po ashtu edhe për praktikantët e menaxhimit të ujërave.

Duke marrë parasysh përmbajtjen e punimit, qasjen shkencore dhe metodologjike të ndjekur, si dhe analizën dhe diskutimin e rezultateve të arritura, komisioni vlerësues konstaton se punimi me titull **“Vlerësimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në pellgun e Drinit të Bardhë”** i plotëson të gjitha kriteret akademike dhe shkencore të kërkuara për punim masteri. Në këtë kontekst, komisioni i propozon Këshillit të Departamentit të Kimisë lejimin e mbrojtjes publike të punimit dhe dhënien e gradës **“Master i Shkencave në Kimi”** për kandidatën **Valmire Krasniqi**.

Prishtinë, 13/10/2025

Komisioni:

1.   
Prof. Asoc. Albana Mehmeti, kryetare
2.   
Prof. Tahir Arbneshi, anëtar
3.   
Prof. Ass. Liridon Berisha, anëtar